



## Informacion mbi statistikat dhe menaxhimin e cilësisë së Shoqatës Zvicerane të Mamive

E nderuar Zonjë\*, i nderuar Zotëri\*

Në rast se jeni shtatzënë ose keni lindur së fundmi, Shoqata Zvicerane e Mamive (SHV) ndihet e nderuar që po kërkon shërbimet e mamisë në këtë kohë të rëndësishme.

Me këtë letër ju njoftojmë se masat për sigurimin e cilësisë janë të nevojshme edhe kur bëhet fjalë për shërbimet e ofruara nga mamitë<sup>1</sup>. Për këtë qëllim, shërbimet e mamisë regjistrohen, vlerësohen dhe paraqiten vazhdimisht në statistika.

### Qëllimet e statistikave të Shoqatës Zvicerane të Mamive

Statistikat e SHV-së janë të rëndësishme për prezantimin e punës së mamisë publikisht si dhe për përmbushjen e kërkesave të përcaktuara në kontratë të cilat janë të miratuara nga Këshilli Federal (Monitoron shërbimet ambulatorë të mamive dhe siguron cilësinë e tyre). Dëshironi t'i hidhni një sy statistikave të SHV-së? Lidhja me faqen e internetit: <https://www.hebamme.ch/qualitaet/statistikberichte-fph/>

### Kontributi juaj

SHV dhe Universiteti i Shkencave të Aplikuara të Zyrihut (ZHAW) kërkojnë pëlqimin tuaj për të lejuar maminë tuaj mbikëqyrëse të regjistrojë në mënyrë elektronike shërbimet që keni përdorur. Së bashku me regjistrimin dhe/ose faturimin elektronik në analiza statistikore do të përfshihen dhe të dhënat personale e shëndetësore tuajat dhe të foshnjës suaj, të cilat janë të nevojshme për statistikat dhe sigurimin e cilësisë së SHV-së.

### Mbrojtja e të dhënave dhe konfidencialiteti

Ne përpunojmë të dhënat e mbledhura dhe të transmetuara tek ne në përputhje me dispozitat e Ligjit Federal Zviceran për Mbrojtjen e të Dhënave (DSG) dhe Ligjin për Informacionin dhe Mbrojtjen e të Dhënave të Kantonit të Zyrihut (IDG), në secilin rast në masën që janë të zbatueshme rregulloret përkatëse. Universiteti i Shkencave të Aplikuara të Zyrihut (ZHAW) është përgjegjës për përpunimin e të dhënave, ndërsa për sa i përket ligjit për mbrojtjen e të dhënave përgjegjëse është Shoqata Zvicerane e Mamive. Të dhënat përpunohen për qëllimin e statistikave të sipërpërmendura dhe sigurimin e cilësisë së SHV-së, gjithnjë duke u bazuar në marrjen vullnetarisht të pëlqimit tuaj. Në mënyrë që të dhënat tuaja të bashkohen dhe të llogariten vlerat e rëndësishme karakteristike nga programuesit (programet e faturimit të mamisë), ato përmbajnë disa informacione personale si numri i sigurimeve shoqërore, viti i lindjes dhe vendbanimi. Këto të dhëna transmetohen në mënyrë të sigurt dhe lidhen me Institutin Kërkimor për Mamitë në Universitetin e Shkencave të Aplikuara të Zyrihut (ZHAW). Pas bashkimit, të dhënat kodohen dhe të dhënat e papërpunuara fshihen dy vjet pas analizave. Kodim do të thotë që numrat e sigurimeve shoqërore të cilët tashmë janë konvertuar, zëvendësohen me numra të rastit. Përveç kësaj, në vend të qytetit të vendbanimit mbahet qarku, dhe moshë juaj caktohet në një kategori. Asnjë përfundim për personin tuaj nuk mund të nxirret nga të dhënat e koduara pa patur një çelës. Çelësi i cili cakton numrat e rastësishëm në vend të të dhënave tuaja dhe në vend të numrave tuaj të sigurimeve shoqërore, ruhet veçmas. Të dhënat mbahen të kçuara në Universitetin e Shkencave të Aplikuara të Zyrihut (ZHAW) dhe ruhen në mënyrë elektronike për t'i mbrojtur ato nga palët e treta të paautorizuara.

Rezultatet e studimit publikohen vetëm në formë anonime, d.m.th. asnjë person nuk është i identifikueshëm dhe nuk mund të nxirren përfundime për individët. Është gjithashtu e mundur që të dhënat e koduara të përdoren për analiza dytësore ose për qëllime udhëzuese në një datë të mëvonshme.

### Aspektet etike

Komiteti i Etikës së Zyrihut ka konfirmuar se statistikat e SHV-së nuk përfshihen në objektin e Aktit të Kërkimeve Njerëzore dhe për këtë arsye nuk kërkohet autorizim shtesë për mbledhjen e këtyre të dhënave.

### Përfitimet

<sup>1</sup>Si pjesë e kontratës aktuale të strukturës individuale të shërbimit, e cila u lidh midis Shoqatës Zvicerane të Mamive (SHV), sigurimeve shëndetsore santésuisse dhe curafutura dhe grupit të interesit për qendrat e lindjes në Zvicër (IGGH-CH<sup>1</sup>), SHV si një partner tarifor së bashku me shoqatat e siguruesve është i detyruar të monitorojë shërbimet e mamisë të rregulluara me kontratë. Po kështu, të gjitha palët kontraktuese janë zotuar të operojnë një sistem të përditësuar, efikas dhe të matshëm të sigurimit të cilësisë sipas nenit 77 KVV dhe nenit 58 KVG.

Me pëlqimin tuaj ju mbështesni SHV-në për të përmbushur këto kërkesa rregullatore.



Pjesëmarrja në mbledhjen e të dhënave statistikore nuk shoqërohet me ndonjë përfitim, disavantazh ose punë të veçantë për ju. Megjithatë, ato japin një kontribut të rëndësishëm në sigurimin e cilësisë së kujdesit të mamisë.

### **Të drejtat**

Sigurimi i të dhënave tuaja është me bazë vullnetare. Nëse nuk pranoni që të dhënat tuaja të përfshihen në statistikat e SHV-së dhe në menaxhimin e cilësisë, mamia juaj nuk do ta faturojë kompaninë tuaj të sigurimit drejtpërdrejt në mënyrë elektronike, por do t'ju dërgojë juve faturën për shërbimet e marra. Në këtë rast, ju duhet të paguani faturën dhe ta dorëzoni atë personalisht në kompaninë e sigurimeve shëndetësore në rast se dëshironi të rimbursoheni. Kjo do të thotë që vetëm të dhënat e kërkuara për faturim do të regjistrohen.

### **Financimi i statistikave të Shoqatës Zvicerane të Mamive**

Statistikat e Shoqatës së Mamive Zvicerane financohen nga vetë Shoqata e Mamive.

### **Personi kontaktues**

Zyra e SHV-së do t'ju përgjigjet me kënaqësi për çdo pyetje që mund të keni.

Email: [schweizerischer-hebammenverband@hebamme-hin.ch](mailto:schweizerischer-hebammenverband@hebamme-hin.ch)

---

### **Deklarata e miratimit**

**Mbiemri, Emri:**

Me nënshkrimin tuaj, ju jepni pëlqimin që mamia juaj mbikëqyrëse të faturojë në mënyrë elektronike dhe që në këtë mënyrë, të dhënat personale dhe shëndetësore tuajat dhe të fëmijës suaj të përdoren për statistikat e Shoqatës Zvicerane të Mamive.

- Jam dakord që të dhënat e mia të mund të përdoren për statistikat dhe menaxhimin e cilësisë së Shoqatës Zvicerane të Mamive dhe mund të transferohen në Institutin e Mamive të Universitetit të Shkencave të Aplikuara të Zyrihut (ZHAW) për këtë qëllim.
- Konfirmoj se kam lexuar dhe kuptuar informacionin mbi statistikat dhe menaxhimin e cilësisë të Shoqatës Zvicerane të Mamive. Pata mundësinë të bëj pyetje dhe jam plotësisht i/e kënaqur me përgjigjet e tyre.
- E di që pjesëmarrja në këtë anketë është vullnetare.
- E kuptoj që të dhënat do të jenë të koduara dhe çelësi do të mbahet i sigurt. Të dhënat do të publikohen vetëm në mënyrë anonime.
- Jam informuar se të dhënat e mia personale dhe shëndetësore do të vlerësohen në formë të koduar dhe do të trajtohen në mënyrë konfidenciale gjatë gjithë kohës.
- E di që të dhënat e mia mund të transmetohen në mënyrë anonime për qëllime kërkimore dhe mësimdhënieje.

**Vendi dhe data**

**Nënshkrimi**